



## KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

### KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më 26.03.2021

#### **Deklaratë për mediat e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, z. Ilirjan Celibashi.**

Në nisje të fushatës zgjedhore e shikoj me vend të sjell në vëmendje të subjekteve zgjedhore, si edhe të gjithë faktorëve të tjerë politik dhe institucional të lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve, që ti përmbahen angazhimeve dhe parimeve:

1. për të respektuar të drejtat dhe liritë politike të qytetarëve dhe konkurentëve të tyre;
2. për të zbatuar rregullat e përcaktuara nga Kodi Zgjedhor dhe aktet e KQZ-së, për të mos përdorur burimet publike për qëllime elektorale;
3. për të mos u përfshirë në praktika kërcënuese ose penguese për të ushtruar të drejtën e votës dhe shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve;
4. për të refuzuar marrjen pjesë në praktikatat e blerjes së votës dhe marrjes së financimeve apo përfitimeve të kundraligjshme, veçanërisht nga ato që vijnë nga aktivitete kriminale;
5. për të bërë publike në kohë reale pranë KQZ-së dhe faqen zyrtare të subjektit politik çfarëdolloj donacioni si dhe të refuzojnë dhurime në mjete monetare apo në natyrë që bien ndesh me dispozitat e Kodit Zgjedhor;
6. për të respektuar dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe udhëzimin e KQZ-së për afishimin e materialeve propagandistike.

Duke vlerësuar se dispozitat penalizuese që parashikon Kodi Zgjedhor nuk kanë si qëllim në vetvete ndëshkimin administrativ të nëpunësve të administratës publike, por rritjen e përgjegjësisë për zbatimin e ligjit dhe të standardeve ligjore, u bëj thirrje subjekteve zgjedhore, kandidatëve të tyre si dhe nëpunësve të administratës publike që të mos lejojnë në asnjë rrethanë përdorimin politik të detyrës dhe stafit të administratës.

Zgjedhësit të përfshihen aktivisht në raportimin dhe denoncimin e rasteve korruptive të shitblerjes së votës dhe financimit të paligjshëm të fushatës zgjedhore.

Zgjedhjet janë për qytetarët, ndaj promovoni dhe debatoni çështje politike pa përdorur gjuhë të ashpër, gjuhë diskriminuese dhe urrjetje.

Një rol të rëndësishëm në mirëadministrimin e procesit zgjedhorë kanë komisionerët zgjedhorë të të gjitha niveleve, të cilët duhet të tregojnë përgjegjshmëri dhe integritet për të respektuar me

rigorozitet ligjin dhe praktikat e mira zgjedhore.

Sot fillon monitorimi i medias, i cili me ndryshimet e Kodit Zgjedhor do të bëhet nga Autoriteti i Medias Audiovizive (AMA). KQZ ka miratuar Metodologjinë e Monitorimit duke marrë në konsideratë manualët e monitorimit të OSBE/ODIHR-it.

Misioni i medias është raportimi me vërtetësi dhe informimi i qytetarëve, ndaj kam besim se media do ta kryej më së miri misionin e saj të rëndësishëm.

Faleminderit, jam i hapur për pyetjet.